

Procesverbal

*Nga Mbledhja I (e parë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:
31.01.2024*

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar;
2. Propozim-vendim për ndryshimin e emrit të rrugës së lagjes "Hajdet" në "Haxhi Rrahmani";
3. Miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026;
4. Formimi i Komisionit për ankesa për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;
5. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-2-0 ZK Dragash (Venezia);
6. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-2-0 ZK Dragash;
7. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-1-0 ZK Dragash (Zyra e Avokatisë, ish-Pro Credit Bank);
8. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës O-70604014-10-2-2-0 ZK Dragash;
9. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës O-70604014-10-2-2-0 ZK Dragash (loali përballë Hotelit "MEKA");
10. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës O-70604014-10-2-2-0 ZK Dragash;
11. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00771-0 ZK Dragash (Byfeja në Shtëpinë e Kulturës - emrin e dertanishëm "Montana");
12. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës P-70604014-00771-0 ZK Dragash;
13. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00905-1 ZK Dragash (Parkingu dhe Tregu i Gjellbër);
14. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës P-70604014-00905-1 ZK Dragash;
15. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00782-2 ZK Dragash (Parkingu te Gjykata - Dragash);
16. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës P-70604014-00782-2 ZK Dragash; dhe
17. Eventuale.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në seancën e parë të rregullt për vitin 2024! Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë. Para se ta qesim në votim rendin e ditës, nëse ka dikush ta marrë fjalën për rendin e ditës? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? A ka abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e

miratojmë rendin e ditës. Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar. A do dikush ta marrë fjalën për këtë pikë? Në qoftë se nuk ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pikës? A ka kundër? Abstenim? Me 25 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës. Pika e dytë e rendit të ditës është: Propozim-vendim për ndryshimin e emrit të rrugës së lagjes "Hajdet" në "Haxhi Rrahmani". A do dikush ta marrë fjalën për këtë pikë?

Driton Ademi: Faleminderit, kryesuese! Atëherë, te pika e dytë e rendit të ditës, unë e kam vërejt që ka një keqpërdorim, sepse i ka 17 nënshkrime, prej tyre janë vetëm 6 kopje të letërnjoftimeve. Edhe tre emra janë të njëjtat aty. Në fakt, në formularët e mëhershëm, qysh i kemi pa, duhet me qenë emri, mbiemri, numri personal dhe nënshkrimi i atyre personave. Dyshimi është për manipulim të kësaj rrugës, për persona të caktuar, ose personat që kanë lidhje me pushtetin, që ndoshta një familje ose dy i ka prurë edhe... për mendimin tim qekjo është shumë e dyshimtë, qekjo pikë e rendit të ditës, se ka manipulim të nënshkrimeve, që janë tre persona me të njëjtin emër edhe janë vetëm gjashtë letërnjoftime në material. Faleminderit!

Arijeta Qaflehi Skeraj: Faleminderit, Driton! A do dikush tjetër ta marrë fjalën?

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Meqenëse Dritoni e ngriti si shqetësim këtë pikë të rendit të ditës edhe dyshimin për manipulim, është mirë me dalë me e dhënë një sqarim kryetari, meqenëse e ka prurë edhe si pikë të rendit të ditës, bashkë me ju kryesuese. Me e hek këtë dyshimin që tash sapo na u shfaq këtu. Faleminderit!

Arijeta Qaflehi Skeraj: Faleminderit, Uran! A do dikush tjetër ta marrë fjalën? Atëherë, e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, me 9 kundër dhe 4 abstenime, kalon edhe kjo pikë. Atëherë kalojmë te pika e tretë: Miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026. E lusim zyrtaren për Barazi Gjinore ta marrë fjalën!

Lindita Kozmaqi Piraj: E nderuar kryesuese, zv/kryesues, kryetar! Të nderuar asambleistë, drejtorë dhe gjithë të tjerë të pranishëm! Më lejoni paraprakisht të uroj kryesuesen për punë të mbarë, meqenëse është seanca e parë që e udhëheq, për koinçidencë, seanca e parë dhe Plani i Veprimit për Barazi Gjinore në seancë. Kështu: falë bashkëpunimit për shumë vite që kemi pas me organizatën UN Women, kemi arrit të jemi në mesin e 11 komunave në Kosovë për hartimin e këtij Plani. Ky Plan është përgatit nga Komuna e Dragashit, si një mjet i zbatimit dhe angazhimit publik për barazinë gjinore, të reflektuar në Kushtetutën e RKS-së, instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërdrejt të aplikueshme në legjisllacionin e vendit, Ligji për Barazi Gjinore në tërësi, ligjet e vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, si dhe tërësinë e kornizave zhvillimore vendore, programe, strategji për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin. Po ashtu, edhe instrumentet dhe mjetet e BE-së të fokusuara tek barazia gjinore,

si pjesë e procesit të integritit, veçanërisht ato që përmbajnë verpime që duhet të ndërmerren në nivel lokal, siç është Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe të Burrave në Jetën Lokale. PLVBGJ u përgatit përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe ndërveprues, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatave të shoqërisë civile. I ndoqi të gjitha hapat dhe rrugëtimin, në mbështetje të projektit të UN Women ‘Gender Equality Facility’, me fonde të BE-së. Më lejoni – para se me hy në procedurat përmbledhëse të hartimit të këtij Plani – të ndalem pak të përkufizimi i barazisë dhe drejtësisë gjinore. Barazi gjinore nënkuptojmë të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje, pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë sjellje, aspirata dhe mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë se burrat dhe gratë duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti pse kanë lindur femra apo meshkuj. Drejtësi gjinore nënkupton që gratë dhe burrat të trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlefshëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompenzojnë për disavantazhe historike dhe sociale të grave. Siç përkshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, në njësitë vetëqeverisëse lokale janë sferat e qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivele që kanë më tepër mundësi ta luftojnë në vazhdimësi riprodhimin e pabarazive, si dhe ta avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurë zbatimin e kompetencave të tyre, në bashkëpunim me të gjithë gamën e akterëve lokalë për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rinjve dhe të rejave, vajzave dhe djemve; zbatimi i drejtë i barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të qeverisjes lokale. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të Komunës dhe përparimeve në këtë drejtim në nivel vendor apo komunal, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për pabarazi dhe padrejtësi gjinore, të munguar në praktikë. Pabarazi dhe diskriminime apo disavantazh i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive, por edhe ndërmjet grupeve përbrenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta, të pranishme në familje, në arsim, kulturë, komunikim, në botën e punës, organizimin e shoqërisë etj. Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi thelbësore, që organet e qeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integritin gjinore në politika, organizim dhe praktikat e tyre. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rinjtë dhe të rejtat, djemtë dhe vajzat, është gjithashtu çelës i suksesit të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura në Plan, janë shoqëruar me të gjitha, lidhur me tregues, rezultate, drejtoritë përgjegjëse, institucionet, partnerët, për zbatimin, afatet kohore, përgjegjësitë, monitorimi, kostoja për zbatim të këtij Plani. Kjo patjetër që ndërlidhet me fushat e

ndërhyrjes, rezultatet, objektivat përkatëse e kështu me radhë. Përgjegjëse kryesore për zbatimin e Planit mbetet Komuna. Kjo nënkupton përgjegjësitë, si për zbatim të drejtpërdrejtë të të gjitha veprimeve të parashikuara në këtë Plan, po ashtu edhe për koordinimin e institucioneve dhe aktorëve përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e masave dhe veprimeve. Pra, nëse Komuna nuk ka mundësi financiare, njerëzore apo infrastrukturore që ta zbatojë drejtpërdrejt një masë apo një veprim të caktuar në këtë Plan, përgjegjësia e saj është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me ato institucione që kanë mundësi, duke përfshirë OJQ-të, institucione private apo organizata ndërkombëtare. Plani i Veprimit Gjinator ka katër objektiva specifike, mirëpo para se me kalu te objektivat, do të ndalem se ky Plan është një mjet i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare për barazi gjinore, është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, me hapa mirë të përcaktuar, me përmbajtje të cilat reflektojnë arritjet, sfidat, ndërhyrjet, pabarazitë, drejtësinë gjinore etj., një pasqyrim i qartë i roleve dhe i përgjegjësisë të domosdoshme që duhet të përmbushen brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës me institucionet lokale apo me organizatat e ndryshme. Metodologjia e hartimit të këtij Plani ka përfshirë fillimisht ngritjen e një Grupi Punues, me vendim të kryetarit, i cili është përbërë prej 11 zyrtarëve, në krye me z.Qamil Kolloni, drejtorin e Finacave që ka qenë kryetar i grupit, për të vazhduar më tej me zyrtaren për Barazi Gjinore, Ademi Eminin, drejtorin Zeni Krasniqi, drejtorin Ibrahim Gashi, drejtoreshën Liridona Misinaj, drejtorin Behar Brenoli dhe zyrtarin për Komunitete, Uzair Hamza, po ashtu Fitim Kurtishin nga Zyra e Punësimit, Salmira Usmeni si shoqëri civile dhe Mimoza Berisha si përfaqësuese nga QPS. Me anë të këtij grupi, fillimisht kemi bërë analizën e situatës, përmes të dhënave, informacioneve ekzistuese, përcaktimin e fushave kryesore të ndërhyrjes, mandej kemi arrit në konsultim përbrenda Komunës dhe akterëve të ndryshëm, për të kalu te postimi në uebfaqe, që është bërë më 13 nëntor deri më 13 dhjetor, ashtu sipas procedurave të përcaktuara të konsultimit publik, ku më 13 dhjetor në ora 11:00 kemi mbajtur takimin publik. Pas takimit publik kemi bërë ndryshimet dhe ndërhyrjet. Dhe, në fund është kostimi i Planit, i cili ishte një process tepër i rëndësishëm që mori një kohë të gjatë dhe është përgatit me mbështetje të organizatës dhe konsulentëve nga UN Women. Por, gjithsesi rolin më të rëndësishëm këtu e ka pas drejtori i Finacave, të cilin e falënderoj për angazhimin dhe vullnetin që ka tregu gjatë gjithë kohës së përpilimit të këtij drafti, e specifikisht në kostimin e tij. Jemi te miratimi i këtij Plani, të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linja jo vetëm të detyrimeve kombëtare, por edhe metodologjisë së përgatitjes, rol të rëndësishëm siç e përmenda UN Women me ekipin e saj të përgatitur me konsulent. Objektivat e këtij Plani, për mos me u ndalë shumë – e keni materialin, është materiali bukur i gjatë – po i cekim vetëm objektivat. Janë katër objektiva strategjikë, mbi të cilin mandej ka objektiva specifike dhe aktivitete. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre; Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave të

reja dhe grave; Zvogëlimi i pabarazive gjinore, në arsim cilësor, kulturë, rini e sport, për gratë e burrat, të rejat e të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre; dhe Promovimi i shëndetit dhe të drejtat seksuale e riprodhuese. Për koston e financave unë nuk do të ndalem hiç. Në qoftë se dikujt i intereson, e kemi të pranishëm drejtorin e Financave. Por, diçka që desha ta potencoj, është se rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore në nivel lokal, luan edhe Grupi i Grave Asambleiste, që për fat kemi dhjetë gra asambleiste, të cilat mund të llobojnë vazhdimisht për sigurimin e fondeve për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë Plan. Në vijim, të gjitha institucionet lokale dhe OJQ-të përfshihen si partnere për veprimet, dhe gjithashtu janë të rëndësishëm pa dyshim donatorët, ku edhe ndoshta shërben edhe si thirrje për të gjitha ata donatorë që kanë mundësi të mbështesin objektivat dhe aktivitetet e këtij Plani të Komunës së Dragashit për t'i shtyrë proceset e barazisë gjinore. Po ashtu, deshta të ju njoftoj se ky nuk është plan i zyrtarës për Barazi Gjinore. Ky është Plan Komunal për Barazi Gjinore, ku janë të përfshirë edhe disa drejtori specifike. Kështu që, për pyetje dhe më në detaje diçka në qoftë se ju intereson, i keni të pranishëm edhe drejtorët. Në kuadër të planeve të këtyre drejtorive, i kanë edhe këto aktivitetet të cilat i kanë paraparë. Për fund, ju ftoj ta votoni këtë Plan, duke e pas parasysh që është për herë të parë në Komunën e Dragashit. Po ashtu, edhe që ka direkt të bëjë edhe me ngritjen e performancës së Komunës sonë. Faleminderit për durimin!

Afrore Vejseli: Përshëndetje! Përshëndetje dhe urime, kryesuese, për detyrën e re! Përshëndetje për të gjithë ju, të nderuar! Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026. Në pjesën kryesore, e gjithë agjenda e këtij Plani është e përqendruar në të drejtat për barazi gjinore, të bazuara në Kushtetutë dhe në ligje, e poashtu edhe në konventat ndërkombëtare. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me GAP dhe e financuar ngë po kjo qendër, e dakorduar me Komunën për një plan veprimi. Me kërkesën e kryetarit të Komunës, për këtë qëllim u formua Grupi Punues për bërjen e Planit të Veprimit, i cili në përbërje ka 11 anëtarë, dhe kur shikohet struktura e këtij Grupi Punues, nuk ka barazi gjinore. Pra, është raporti 7 me 4. Ndoshta kryetari në emërime mund të arsyetohet se ka përfshirë të gjithë sektorët e Komunës, ama këta sektorë kanë edhe shumë gra dhe vajza për ta balancuar këtë Grup Punues. Në tërësi, pjesë më e madhe e këtij Plani përshkruan kontura të përgjithshme mbi barazinë gjinore, duke u referuar dokumenteve të përgjithshme të cilat i ceka më lartë. Ligji për Barazi Gjinore është obligative për Komunën, prandaj ne detyrohemi të bëjmë plane për ta ngritur këtë në shkallën më të lartë. Në këtë Plan duhet ecur në dy drejtime. E para, duke zbatuar ligjin dhe, e dyta, duke u përshtatur në specifikat e Komunës sonë. Barazia gjinore nuk është luks, por është një e drejtë esenciale për shoqërinë demokratike. Ne kemi detyrë dhe obligim që të luftojmë dukuritë e ndryshme kulturore, të cilat në jetën e përditshme shtypin të drejtat e grave. Ne nuk duhet të mjaftohemi se kemi ligje të mira për barazi gjinore, sepse në praktikë realiteti është ndryshe. Në vitet e mëhershme, gratë janë përmendur vetëm më 8 mars, ditën e tyre, jo për të bërë diçka për barazinë gjinore, por për t'u parë në mes vete dhe,

sigurisht, edhe për ndonjë dhuratë modeste. Mund të ketë pasur edhe ndonjë organizimi nga Zyra për Barazi Gjinore, por shumë rrallë. Në një nga objektivat strategjike thuhet: 'Pjesëmarrja e të rejave dhe grave në vendimmarrje është përmirësuar'. Me siguri e keni menduar se me zgjedhjen e kryesuese keni përmirësuar diçka. Jo, të nderuar! Gratë dhe vajzat tona janë të gatshme për pjesëmarrje publike, vetëm se duhet t'u krijohet kushten e tyre. Ato kërkojnë që të bisedohet familje për familje, që ato të njoftohen për të drejtat e tyre. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Të nderuar të pranishëm, e dëgjova me vëmendje këtë plan dhe e vetmja gjë që nuk më është e qartë është Gender equality facility, nuk e kuptova fare, megjithëse e kuptoj mirë gjuhën shqipe dhe serbe. Nuk mendoj se kjo është një fjalë që përdoret në kongregacionin tonë. Zonja Piraj, dhe patëm një diskutim të shkurtër se sa do t'u kushtojë kjo strategji qytetarëve të komunës sonë, falë njeriut që do të jetë fotografia në kanaqen e gullashit të viqit, i cili e ndërpreu atë diskutim dhe nuk na dha kohë të mjaftueshme për t'ju pyetur në detaje për këtë çështje. Unë do t'ju lutesha juve apo kujtdo nga qeveria që të vini në këtë foltore dhe më e rëndësishmja, t'u tregoni qytetarëve të komunës së Dragashit se sa do t'u kushtojë kjo strategji. Kjo është gjëja më e rëndësishme, kështu që le të vazhdojmë. Gjatë prezantimit tuaj, vura re se në planin tuaj po diskriminoni popullatën mashkullore. Ju gjithmonë flisni për atë se si popullata femërore diskriminohet. Si duhet të punësohen gratë, ju flisni për shëndetin e grave dhe të ngjashme, flisni për barazinë gjinore. Vazhdoni punën e mirë, mos i favorizoni gratë. Në bazë të informacionit të përgjithshëm që kemi dhe çfarë mund të shohim në terren, nuk besoj se ndonjë grua është e diskriminuar për sa i përket punësimit. Prandaj po ju lus pasi dhe nuk na lejuan të na përgjigjeni se sa do t'u kushtojë qytetarëve të komunës sonë kjo strategji e juaja për vitin 2024-2026. Do të doja t'ju pyesja edhe një herë pa politikë sepse ne jemi ata që e drejtojmë politikën këtu.

Driton Ademi: Faleminderit, kryesuese! Unë e kam një pyetje për zyrtares. Pse e keni prurë këtë Plan të Veprimit në Kuvend, me u miratue nga ky Kuvend, kur së paku kryetarja e gruas së këtij Kuvendi Komunal nuk është e përfshirë në Plan të Veprimit. Ne kemi më shumë se 30% të grave që janë pjesëmarrëse në Kuvend, edhe nuk është e përfshirë aty. A u dashtë vetëm akterët e qeverisjes me qenë këtu, e nuk e përfshini Kuvendin Komunal. Kurse ju në fund po e bini këtu në Kuvend për më jua miratue na. Atëherë nuk e shoh të arsyeshme na me jua votue këtë Plan të Veprimit, kurse asnjë anëtar nuk përfshihet në këtë Plan. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Përshëndetje kryetar, kryesuese, të pranishëm dhe të gjithë ju delegatë! Unë thjesht si kryetar i këtij Plani, që është dashtë ta miratojmë dhe ta punojmë, është si obligim ligjor i qeverisë që na detyron dhe është i detyrueshëm. Prej këtij Plani duhet të merren detyrat për t'u realizuar. Sa i përket kostimit, unë mund të ju them se ky Plan është prej 2024-2026. Ky Plan ka një të mirë dhe për herë të parë është përdorë një strategji për përpilimin financiar, që përmban në vete hendek buxhetor. Ata të

cilët nuk janë ekonomist, nuk mund ta kuptojnë se çka nënkuptojmë me hendek buxhetor. Për arsye se, përpos të gjitha kalkulimeve të cilat janë bërë në bazë të standardeve ekzistuese, për mëditje, për veprime, për konsulent dhe të tjera, dhe është ndarë në njësi, dhe janë paraparë të gjitha investimet që realisht deri më tash Komuna, në mënyrë të vetëdijshme, i bën për barazi gjinore, i kemi specifikue dhe i kem gjet në gjendjen reale. Në qoftë se e shihni – ju e dini se na ndajmë subvencione – për fat të mirë që numrin e subvencioneve që kemi shpërndarë, sa i përket studentëve, numri më i madh i përfituesve janë gjinia femrore. Dhe, kjo është një kënaqësi. Pas të gjithë këtyre shpërndarjeve buxhetore që ne veç i bëjmë, si në shëndetësi, gjithashtu në DKRS dhe në Drejtori të Financave, në arsim, ne e kemi gjendjen edhe shtimin e numrit të gjinisë femrore. Nga KAB 2024-2026, kemi realizue objektivin 2023 të cilin e kemi parapa. Nga 21% i angazhimit të punëtorëve të arsimit femra, në 30%. Kjo është gjendja reale. Edhe ne do të kishim dashtë t'i kemi 50%, mirëpo me vetë hapjen e shkollës që është bërë tash në Bresanë, për fëmijë parashkollorë, faktikisht ne kemi mbërri në kuotën 30%. Këta janë të mirë. Në këtë Plan është paraparë që të gjithë, si delegatët, si zyrtarët komunalë, të marrin detyra për t'i realizuar objektivat që duam t'i arrijmë. Gjendja qysh është – Afrore – është e këtitillë qysh është, në këtë gjendje jemi ne. Ne nuk mund të themi ndryshe, jemi më mirë ose jemi më keq. Ne e dimë të gjithë gjendjen qysh e kemi, mirëpo pikërisht këtë gjendje kemi kërkue që, përmes këtyre objektiveve, përmes këtyre detyrave që do t'i marrin të gjithë drejtorët, gjithashtu edhe ky Kuvend, do t'i shpërndajmë dhe do të angazhohemi, do të mundohemi ta përmirësojmë këtë gjendje, që në 2026-tën ta kemi më mirë dhe mos ta kemi këtë gjendje. Prandaj, pse është përfshirë, janë disa kriteret të cilat na i kanë parashtruar, sepse jemi në mesin e 11 komunave të cilat për herë të parë e realizojmë PLVBGJ-në, në bashkëpunim me organizatën UN Women. Dhe, duhet të ndiejmë kënaqësi, se kemi dhënë një kontribut që ky Plan në fund të vitit do të na merret parasysh edhe të Granti i Performancës, e ju e dini që përmes këti granti na përfitojmë për komunitetin. Besoj se hendeku buxhetor i bën mirë çdo akteri që ka ide, qoftë çdo drejtorati, gjithashtu edhe grave të cilat janë delegate, që kanë iniciativa dhe mund t'i parashtrojnë projektet e tyre ideore, mund të mbështeten. Ky Plan u jep mundësi dhe mund të mbështeten nga fonde të ndryshme, për arsye se parashih të hyrat, mbështetjen financiare komunale, mbështetjen nga OJQ-të, nga Qeveria dhe gjithashtu parashih që mund të merren fonde të ndryshme ndërkombëtare. Pra ky Plan, në qoftë se veprohet në bazë të këtij Plani, janë të hapura të gjitha rrugët që ne të arrijmë t'i realizojmë objektivat deri në 2026-tën.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Unë deshta me u fokusue ma shumë te disa anëtarë – prita prej jush që ta dridhni Kuvendin me argumente, por po heshtni. Nuk bën me folë jashtë Kuvendit, duhet me folë këtu në foltore, me argumente, se keni dëshmi, argumente keni, ju opozita sidomos. Po pse po heshtni? Mos folni në prapavijë, në rrugë, në vende jopublike, folni këtu ku është zyrtare. Ne jemi këtu për me e mbrojt shtetin edhe Kosovën, edhe Kuvendin, edhe investimet

edhe çdo gjë. Unë kur kam qenë në opozitë, edhe kur s'ma kanë dhënë fjalën, kam dalë kam folë. Por, jo me qëllim me i akuzue, por me e mbrojt shtetin, Komunën. Ju po heshtni! Sot është para nesh një dokument voluminoz dhe me strategji shumë të mirë që ne, për shembull, duhet këtu t'i fokusojmë edhe shqetësimet që i kemi, edhe në komunitet, edhe ne duhet t'i ngritim këtu. Po e shoh që kurgjo, vetëm për do komisione. Po, anëtarët e komisioneve normal, por pse? Se Kuvendi nuk është i përfshirë. Fyerje, fyerje, ofendim i rëndë! Ju asnjëri s'e përmendet. E përmendet barazinë gjinore, e përmendet vetëm barazinë gjinore, zotëria i PDK-së, Driton Ademi, tri fjali. Kuvendi nuk është i përfshirë, QKMF-ja nuk është e përfshirë, QPS-ja me dy anëtarë. Drejtori i Drejtoratit po. Kryetar Qamil Kolloni, prezantimin e bën Lindita Piraj. Unë s'po kuptoj, a është për barazi gjinore kjo, a veç për femra. Nëse është veç për barazi gjinore, atëherë unë ndihem i diskriminuar. Ju faleminderit!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, z.Samidin! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Jo Nexho, ke folë për këtë pikë, nuk t'u përmend emri. Të lutem, Nedžmidin! Uran Halimi e ka fjalën.

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! E dita që s'ia dhaje fjalën Nedžmidinit edhe dola me e bo pyetjen që u parashtrua pak më herët. Folëm edhe pyetëm për koston e këtij Plani. Drejtori realisht i tha disa fjalë, po s'tha atë që na e kërkuam. Drejtor, mundesh me na dhënë përgjigjen ma konkretisht. Faleminderit!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Uran! A do dikush tjetër? Në qoftë se nuk ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij Plani? Shpetim unë fola, kush do, ai nuk deshti me e marrë fjalën drejtori. Nëse ke diçka, hajde!

Shpetim Hajredini: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Përshëndetje, i nderuar kryetar, kolegë asambleistë! Nuk po hyj në detaje, se unë i takoj fesë islame edhe mundohem me e respektue në tërësi islamin, kështu që s'merrna shumë me këto plane se s'më nevojiten mu në jetë, por besoj edhe të gjithë atyre të cilët i takojnë islamit, s'kanë nevojë për me na mësue me këso plane, cilat janë të drejtat e femrës e cilat të meshkujve, se na i dimë ato mirë. Por megjithatë, masi e kena veç ligjërish me e përmbushë, duhet ta përmbushim. Unë dola në emër të Grupit të PDK-së, e bëri një kërkesë ma herët, një pyetje e parashtrori për drejtorin, për shumën totale e cila do të aplikohet në këtë Plan të Veprimit. Drejtori nuk e dha përgjigjen. Mundësisht me dalë, me na dhënë përgjigjen, se çfarë shumë, çfarë kosto ka ky Plan. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues! Të nderuar delegatë, përfaqësues të OSBE-së, mjete të informimit, ju përshëndes të gjithëve! Ju falënderoj për pjesëmarrjen në seancën e parë të këtij viti të Asamblesë Komunale. Unë dola vetëm të bëj një sqarim lidhur me PLVBGJ-në. Ky është një Plan lokal, nuk është dokument i zyrtarës për Barazi Gjinore, ky është një dokument komunal, me të

cilin ne jemi të obliguar që patjetër këtë ta miratojmë. Ky është një dokument i cili do t'i ndihmojë Komunës që të bëjë një balancim dhe një orientim të mirë të mjeteve, në mënyrë që në të ardhmen ne si Komunë e Dragashit të mos jemi në vendet e fundit sa i përket barazisë gjinore, por duhet të punojmë që sa më shumë, që të ngritemi sa më lart kësaj tablele. U parashtrua pyetja se pse nuk ka anëtarë të Kuvendit në Grupin Punues. Është konflikt interesi, për arsye se Kuvendi këtë duhet me e miratue. Kjo është punë vetëm e ekzekutivit dhe në bazë të ligjit dhe kërkesave është bërë edhe Grupi Punues. Ky Plan i Veprimit, Komunës nuk i kushton asgjë, vetëm i orienton mjetet që ekzistojnë, me e bë një balance gjinor, dhe gjithashtu nga ky Plan, nëse miratohet, Komuna do të ketë përfitime, sepse mund të thith edhe mjete jashtë buxhetit, mjete financiare edhe nga donatorët, edhe nga OJQ-të, edhe nga Qeveria. Kështu që, unë besoj që ky nuk është vetëm Plan i zyrtares për Barazi, por është Plan i Komunës edhe i juaji e i të gjithëve, kështu që meriton të aprovohet, për arsye se me këtë mund të përfitojmë vitin e ardhshëm edhe në Grantin e Performancës. Faleminderit!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, kryetar! Shpetim, nuk t'u përmend emri, po më vjen keq, masi Nedžmidinit nuk ia dhashë, atëherë nuk po ia nisi. Atëherë masi u shterrën debatet, e qesim në votim pikën e tretë: Mirartimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026. Urdhëro, Nexhat Selaj!

Nexhat Selaj: Përshendetje për të gjithë, përshendetje kryetar, kolegë asambleistë! E përcolla me vëmendje këtë sqarim të cilin në bëri Lindita dhe drejtori, por edhe kryetari. Po më duket, kryetar, po e shoh këtu se ju e keni vetëm sa për performancë, me e fitue një performancë këtu. Nuk po shoh – ne në ato shkrimet që kemi, kemi disa shtylla të harxhimeve buxhetore të cilat duhet të bëhen, që duhet të është një sqarim, sa është ajo kosto, sa kushton ajo, ku shkojnë ato mjete. Unë shumë me vëmendje e kam përcjellë edhe e kam lexue. Nuk mund të jem aso kundërshtar i barazisë gjinore, se nuk i përkas atij rangui. Por, barazia gjinore krijohet vetëm në ato momente kur krijojmë vende të reja të punës për gjininë femrore, jo për ligjërata. Kështu që unë po shoh që vetëm për performancë i keni këto, për asgjë tjetër hiç. Faleminderit!

Agron Gashi: Së pari ju përshëndes, kryetar! Përshendetje për juve, znj. Arijeta, që sot është udhëheqja e parë e juve, suksese në punë! Përshendetje për ju të gjithë, asambleistë! Atëherë, unë vetëm pak desha të kyçem lidhur me barazinë gjinore dhe me të drejtën e grave, po sikur të bëjmë një analizë më kuptimin e të gjithë Kosovës, Komuna jonë mund të llogaritet një komunë ku është gjinia femërore më e diskriminuar në nivel republike të Kosovës. Atëherë, këtë e dini të gjithë ju, dhe juve kryetar, si ekzekutiv i ri, por edhe ne asambleistët, duhet që me një përkushtim të madh t'i japim përkrahje këtij drejtimi. Unë me kolegët e mi, vetëm një analizë të thjeshtë bëmë, a thua në Komunën tonë, në kuptimin e drejtimit arsimor, a është dalë në pension ndonjë e gjinisë femërore deri më tash? Ata nuk ditën të më japin përgjigje fare. Atëherë, nga kjo, ne, nga traditat e zakonet që i kishim në këtë trevë, e lanë sikur

gjininë femërore anash. Mirëpo, neve tash duhet të bëjmë hapa më të nxituar se që duhet, fondacione, buxhet komunal duhet të ndajmë ashtu meritueshëm, me qëllim që, të paktën të bëhet një parafrazim, sepse vërtet jemi larg si Komunë, në krahasim me komunat e tjera. Dhe, unë kisha propozuar që, edhe në kuptimin buxhetor, t'i jepet përkrahje nga Komuna. Por edhe gjithashtu, znj.Kozmaqi tha se ne do të bëjmë hulumtime edhe jashtë vendit, me fondacione të ndryshme dhe me organizata të ndryshme, me qëllim që t'i japim përkrahje, por e tëra është që Kozmaqi më herët ju tha se drejtori rreth financave di më shumë. Drejtor, e treta herë është që të kërkohet një përgjigje. E ke fjalën!

Qamil Kolloni: Përsëritet për të gjithë! Unë po mendoj se e keni marrë materialin të gjithë. Kemi pas edhe dëgjime publike, keni qenë edhe të ftuar, e keni pas edhe në uebfaqe, janë përcjellë të gjitha procedurat. Ju e keni edhe para vetes, kush e ka. Atëherë po shkojmë fjalë për fjalë. Unë e di që për një ditë ekonomistë s'un bonu. E keni për njësi shpenzimin dhe kalkulimin. Ju shkruan shumë thjesht. 40 euro Komuna i paguan, edhe pse nuk i japim pare, është e paraparë se me rregullore e kemi na shfrytëzimin e sallës, mbajtjen e takimit. Kqyrne, lexone se e keni aty. Tri takime vjetore i kemi paraparë, që i kemi kalkulue 200 euro shpenzime ditore. Në qoftë se përdorim konsulent, kemi thënë dy konsulentë, që me normë 53 euro është mëditja, konsulent të jashtëm. Dhe, kemi thënë 25 ditë pune nga 4.5 euro, diku 25 gra kanë me qenë pjesëmarrëse, nga 4.5 që kushton çmimi jashtë orarit të punës, 113 euro. Dhe komplet ai takim kushton 859 euro, Komuna paguan 153 euro, dhe hendeku financiar është 706 euro, që nënkupton se pjesëmarrja e një donator për mbajtjen e një takimi, qoftë për promovimin dhe për mbrojtjen e grave dhe të drejtat e tyre, gjithashtu edhe për obligime për diversitet, gjithashtu për mbrojtje seksuale, kushton kaq. Kushdo që e merr këtë iniciativë, ka mundësi që me këto shpenzime ta realizojë një ditë edhe një takim të tillë. Përgjegjëse nga Komuna është zyrtarja për Barazi Gjinore, i dhashë të drejtë si kryetar i Grupit Punues që le ta bëjë paraqitjen. Prandaj, në qoftë se doni, shkojmë për secilin takim veç e veç. Unë isha shumë konkret dhe isha shumë real. Samidin, të nderuar delegatë, i kemi të ndara 100 mijë euro për subvencione, dhe janë këto shpenzime, janë krijuar edhe vitin e kaluar. Dhe kjo është gjendja faktike. Tash, në këto 100 mijë euro kanë të drejtë të qasjes, se po flasim për të drejtat e grave, kanë të drejtë të qasjes të gjitha gratë dhe, për fat të mirë, herën e fundit subvencionet që janë dhënë për bursa të studentëve, numri i femrave është më i madh. Në bujqësi na nuk mund t'i ndërrojmë, qato organizata të cilat i kanë të regjistruara fermat dhe janë fermere, qato marrin subvencione. Ne nuk mund ta shtojmë numrin e fermerëve, derisa ato vetë nuk e kanë marrë një iniciativë që të janë të regjistruara si fermere. Në qoftë se nuk është ashtu, e kemi një shembull më konkret që ka edhe firmën dhe e kemi këtu. Pran, ne kemi bërë një analizë të gjendjes faktike për secilin sektor veç e veç dhe kemi ardhë në këto përfundime. Kjo kosto mund të rritet dhe mund të ulet. Ky është një Plan që mund të realizohet edhe mund të mos realizohet, por esenca e këtij Plani është se është një plan i thjeshtësuar, që është i kapshëm dhe i specifikuar konkretisht për Komunën e Dragashit. Për

aq sa kemi pas dijëni. Ka njerëz edhe më të dijshtëm, mund ta bëjnë edhe më të mirë, ne ju hapim rrugën edhe atyre. Por unë mendoj se për momentin actual është bërë zgjidhja më e mirë e mundshme dhe një Plan që është konform standardeve, siç e ka kryeqyteti shqiptar Tirana, që e kemi reduktue, sepse jemi konsultuar me konsulentë të jashtëm, e kemi reduktue për specifikat e Komunës së Dragashit.

Samidin Xheladini: Faleminderit, drejtor i Financave! Kryetar, faleminderit për spjegimin! Po të ishte menaxhimi në dorën tënde, ma mirë se në dorën time. Më i sigurt se në dorën time. Kush e menaxhon dhe kush e zbaton? Kam hezitime, kam dyshime. Nuk po due me pas hezitime dhe dyshime, po due – Plani është në rregull, krejt jemi dakord me e zbatue, me votue me unanimitet – po dona në praktikë, Plani a do të shkojë mirë apo jo. Garancion due unë, që 1 euro nuk due me u keqpërdorë. Ky është qëllimi i krejt problemit. Unë dje në Komitet kam folë, sot jam tërheq, nuk do të flas. E kam dëgjue audio çka kam folë dhe prapë kam me bo, edhe në qoftë se ka nevojë kam me jau ofrue njerëzve, unë kam dyshime se njerëz, zyrtar, delegat dhe njerëz, qytetarë flasin, se ka dhe ka pas keqpërdorime. Unë kam kërkue zyrtarisht, për me më bind mu edhe të tjerët, me na ofrue dëshmi se puna e bërë deri më sot ka qenë në rregull. Jam keqkuptue. Prapë po them, kush do ta zbatojë këtë Plan. Po të ishte në dorën e kryetarit, unë kam besim më shumë të ai se te vetja jeme. Edhe pikë. Edhe unë nuk kam dyshime, ju të nderuar delegatë, ju keni shfaq shqetësime. Jo për diçka që unë dyshoj – jo, fare hiç – unë i kam ngrit çështjet të cilat i keni parashtrur ju para meje. Dhe, zbatimi duhet të jetë korrekt, pa asnjë euro keqpërdorim. Për atë kërkova prej jush, që të ketë një monitorim të duhur edhe mos të ka keqpërdorim, se Plani është shumë i mirë edhe është shumë në rregull. Prapë po them, veç barazi gjinore, veç femrat, femrat. Pse veç femrat, s’është atëherë barazi gjinore. Atëherë le të flitet për femra, mos të flitet për barazi gjinore, se unë thashë parëz jam i ofenduar, edhe ju pse s’po ndiheni të ofenduet. Nuk ka të bëjë... për të drejtat e grave atëherë flasim. Për të drejtat e grave, jo për barazi gjinore. Se faktikisht, meshkujt po diskriminohen. Ju lutem! Faleminderit!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Samidin! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nedžmidin, rreth këtij diskutimi, dy minuta!

Nedžmidin Sejdilar: Unë do t’i kërkoja zonjës kryetare të Kuvendit që herën tjetër të më shkruante një fjalim, pastaj do të vij këtu në foltore dhe pastaj do të recitoj atë që ju përshtatet. Unë jam një delegat këtu për të mos u pajtuar me ju dhe jo për të rënë dakord. Zoti Samidin kishte absolutisht të drejtë kur bënte çdo pyetje. Z. Koloni erdhi këtu si ndonjë driblues, për të na dribluar dhe për të mos na thënë qartë se sa i keni parashkuar fondet. Na thuaj, mos na thuaj, salla kushton 53 euro, konsulenti publik 53 euro duhet të jenë dy gjithsej 113 euro, sa është matematika juaj 53 + 53 është 106 dhe jo 113. Hajde këtu pas foltores dhe na thuaj sa do t’u kushtojë qytetarëve komunes jonë në total ky plan. Na intereson sa para keni ndarë ju si zyrtar komune për këtë plan. Kërkoj nga zonja Piraj që të paktën t’i përgjigjet pyetjeve të z.Xheladini. Kush do ta zbatojë këtë plan. Dhe ju, zonja kryesuese, lexoni rregulloren e

punës së kuvendit, neni 10, pika .1. pika 1.2. Faleminderit.

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Nuk desha të bëj replikë. Kryetari i Komisionit, z.Qamili. Drejtor, e ndieva pak veten si të ofenduar, kur na u drejtove se për dy javë s'un ju bëj ekonomista. Po më vjen keq, edhe na s'un të bëjmë ty për dy ditë për tri asambleist. Por, ju e zbutni fjalorin, që të kuptojë e gjithë popullata. Është ndryshe të flasësh me një ekonomist, që të kupton. Ne nuk i përkasim asaj fushës së ekonomisë, nuk e kuptojmë atë termin ekonomik 'kanal' apo 'hendek', e si po i quan. Fol shqip, le të marrin vesh të gjithë. Ne jemi asambleistë dhe votën e marrim nga qytetarët. Kështu që, fjalori juaj duhet të është aq i butë, aq i thjeshtë, sa që të gjithë dëgjuesit të cilët na përcjellin që të kuptojnë për të gjitha ato se çfarë ju deklaroni. Shuma duhet të është e caktuar, sa është shuma? Kjo është e pesta apo e gjashta herë, nuk po hezitoj asgjë, po shuma duhet të caktohet sa është ajo shumë. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! Realisht, Planin na e kemi lexue, po arsyeja që bëjmë ne pyetje janë qytetarët edhe llogaridhënie ne duhet t'u japim atyre. Meqë e përmendi edhe profesori para meje, drejtor i nderum, pse s'jam t'u të kuptue, ose s'je t'u më kuptue, goxha po ma fyesi inteligjencën. Pyetja është shumë e thjeshtë, pa fjalë tjera, pa mëditje, pa numra, pa terma ekonomike. Sa është kostoja totale, o drejtor? Është shumë e thjeshtë, qekaq ka me kushtue edhe ditën e mirë. Faleminderit shumë!

Qamil Kolloni: Të nderuar delegatë! Hapni faqen 15 dhe 16! Kostoja totale e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 1,824,345 euro.

Shpetim Hajredini: Atëherë, edhe një herë përshëndetje për të gjithë! I nderuar drejtor, gjithmonë, në çdo seancë, një herë po e gjun gurin e po e fsheh dorën. Po na lë neve një herë me dalë me e vazhdue seancën pa nevojë, edhe në fund prapë po e jep përgjigjen e saktë. S'po e di pse po e bën këtë gjest. Megjithatë, sa i përket çështjes ekonomike, të rri përballë qysh dësh ti edhe si të dësh ti. Po këtu s'ka të bëjë me ekonomi, se kjo është send i thjeshtë, kjo s'ka të bëjë me ekonomi kurgjo. Po sa i përket ekonomisë, nëse ke dëshirë, përballna ti qysh dësh. Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Normal, detyrë e opozitës është me bo pyetje edhe me marrë sqarime. Por, unë dola këtu mos të krijohet një huti në opinion. Nuk kushton projekti 1 milion e 800 mijë euro! Mundeni ju me u qesh, po unë deshta me jua sqarue, se edhe ju e dini, po e keni ju një qëllim tjetër: me bo dezinformim në opinion. Gjoja se ky projekt kushton kaq. Unë thashë kështu: ky projekt nuk i kushton Komunës asgjë, është në kuadër të buxhetit që e keni miratue ju në muajin shtator. Por, vetëm ato që i keni miratue ju, i kanë qit në letër, në mënyrë transparente, me ju tregue ku kanë me shkue paret. Do të thotë, kurgjo, bile-bile, me këtë Plan Komuna do të ketë përfitim, jo humbje. Edhe, sa i përket kontrollit të buxhetit, kush do ta shpenzojë këtë, do ta shpenzojnë të gjitha drejtoritë komunale edhe Komuna këtë, e jo zyrtarja për Barazi Gjinore. Këtu janë të përfshira edhe subvencionet, edhe buxheti, edhe

investimet kapitale, edhe i uji që po e biem është i përfshirë, që ndahet 50-50% se do ta shfrytëzojnë edhe barazia gjinore, edhe qytetarët. Kështu që, ky Plan është vetëm me e bo një transparencë për qytetarët. Është detyrë e juaja edhe obligim i juaji që me bo huti në opinion, po këtu nuk ka huti, kjo është brenda buxhetit që e keni miratuar ju. Kështu që, unë i ftoj delegatët që ta miratojnë këtë Plan, sepse është në dobi të Komunës. Unë nuk thashë që po e bëjmë këtë vetëm për me e përfitue Grantin e Performancës. Këtu ne këtë po e bëjmë për me e bo një balancim gjinor të shpenzimeve, edhe me ditë me i tregue që këto shpenzime nuk janë të orientuara vetëm për gjininë mashkullore, por janë të orientuara edhe për gjininë femërore. Ky është qëllimi i këtij Plani, prandaj ata të cilët mundohen me bo dezinformata, sigurisht që populli do t'i sheh. Edhe, do të ketë një kontroll të menaxhimit të shpenzimeve. Ju e dini që për një shpenzim që bëhet, gjashtë zyrtarë komunalë duhet së pari ta qesin nga një nënshkrim për me e bo një pagesë. Kështu që, nuk është zyrtarja për Barazi Gjinore, bile-bile ajo nuk qet nënshkrim fare për shpenzime, vetëm bën kërkesë. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Kryetar, me keqardhje, unë nuk e kuptoj fjalën 'dezinformatë'. A është dezinformatë kjo çka del shuma reale, 1 milion e 800 mijë euro janë të ndara për të drejtat e grave, a është kjo dezinformatë, apo është dezinformatë që thoni nga këto para, nga ky buxhet do të shpërndahen edhe te Ujësjiellësi. Veç ma dallo këtë! Nese ndahet shuma 1 milion e 800 mijë euro – që nuk jam kundër – po të hapen vende të reja të punës me 1 milion e 800 mijë euro, të kemi na programe, projekte, se si do të harxhohen ato, jo një dorë, pod y do t'i ngre, nëse është e mundshme edhe tri me i ngrit. Por këtu nuk kemi asgjë të saktë. 1 milion e 800 mijë euro, vetë nga drejtori dëgjuam se shuma është kaq. E tash, kur ndahen 1 milion e 800 mijë euro, unë nuk e di për çfarë e përziejme tash me ujë, këto janë të dedikuara për gjininë femërore, për gratë dhe të drejtat e grave.

Uran Halimi: Tash, prej përgjigjeve që na i dha drejtori edhe parafolësit, mandej edhe kryetari tha që ky projekt kushton 1 milion e 800 mijë euro, po nuk kushton 1 milion e 800 mijë euro. Goxha po bëhem konfuz në këtë përgjigje. Mandej tha që nuk i kushton kurgjo Komunës, e mëditjet veç u përmenden, ato 53 eurot, më herët. Tjetra, tha kryetari, që kjo ka me shpërfaq një transparencë financiare. Ne kemi pika të rendit të ditës ku bëhet raporti financiar komunal. S'munden qe ky dokument me bo transparencë financiare. Pjesa tjetër, ku e shfrytëzoi për politikë, tha që qytetarët e shohin se çka po ndodh. Unë kam besue që kamera e Zotit e sheh. Ajo s'e ka pa, e lëre mo qytetarët. Faleminderit!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Uran! Atëherë, e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, zero kundër dhe 10 abstenime, e miratojmë këtë pikë të rendit të ditës. Pa fillue te pika e katërt e rendit të ditës, delegatë të nderuar, nëse ndonjëri nga delegatët mund të keni ndonjë konflikt interesi të mundshëm për pikat që do të vijnë tash, është mirë që të mos marrin pjesë në votim për pikat që ata mendojnë se kanë drejtpërdrejt konflikt interesi.

Atëherë, po fillojmë me pikën e katërt: Formimi i Komisionit për ankesa për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës. A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë, i ftoj të gjitha partitë politike të japin propozime për të marrë pjesë nëpër komisione. Pasi që PDK është partia më e madhe, a e keni ndonjë propozim për Komisionin për ankesa? Komisioni për ankesa është me mandate dyvjeçar, dy janë nga ekzekutivi i Komunës, një është përfaqësues i OJQ-së edhe dy nga anëtarët e Kuvendit, nga partitë të cilat janë më të mëdha.

Driton Ademi: Nga radhët e PDK-së, propozoj Shpetim Hajredinin.

Naser Myrtezani: Ne si grupim politik propozojmë Anesa Mehmetin.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Atëherë, Komisioni për ankesa, nga ekzekutivi i Komunës është Fadil Sinani, Rilind Tahiri, përfaqësues i OJQ-së është Orhan Tosuni, përfaqësues i PDK-së është Shpetim Hajredini, përfaqësuese e LDK-së është Anesa Mehmeti.

Shpetim Hajredini: I nderuar kryetar, deshta ta di, këtë emrin prej OJQ-së kush e ka propozue. Kanë qenë vetë ata, a? Se me ligj, duhet vetë OJQ-të me emërue personin. Është ligjërisht sot të jetë ai këtu. Po, unë plotësisht po kuptoj që e kanë emrin e vet, po kush i ka emërue tash? Jo, absolutisht s'kam të drejtë unë, ligjërisht ka të drejtë vetëm një person adekuat i OJQ-ve, që ka pjesë në OJQ. Kjo nuk është në rregull, është dashtë të jetë këtu një përfaqësues i OJQ-së, kushdo që të jetë ai, edhe ta propozojë emrin e vet apo të dikujt tjetër që përfaqëson, e jo të propozohet nga ekzekutivi. Ky është emër i ardhur nga ekzekutivi.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Shpetim! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij Komisioni për ankesa? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë këtë pikë të rendit të ditës. Atëherë fillojmë me pikën e pestë: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-2-0 ZK Dragash (Venezia). Atëherë, lusim prapë përfaqësuesit e PDK-së, nëse duan të marrin pjesë në këtë Komision!

Shpetim Hajredini: Në emër të Grupit të PDK-së propozoj Suada Bajramin.

Naser Myrtezani: Ne propozojmë Samidin Xheladinin.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Atëherë, Komisioni i vlerësimit për lokalitetin 'Venezia' është: Isljam Redzeplari dhe Brendi Berisha nga ekzekutivi i Komunës, Jeton Qengaj nga OJQ 'Avoko', Suada Bajrami nga PDK dhe Samidin Xheladini nga LDK.

Nedžmidin Sejdlari: Zonja Kryesuese, pak më parë folëm për barazinë gjinore. A keni tani barazi të gjitha komuniteteve në atë komision? A do të vijë dikush të më përgjigjet për atë çështje? Tjetër gjë të nderuar qytetarë, shikoni pasqyrën e qeverisë, sa i respektojnë ata vetë komunitetet që janë në koalicion me ta. Tashmë jemi duke formuar dy komisione, por nuk u ka shkuar mendja të spropozojnë në mënyrë figurative edhe dikë nga komuniteti.

Arijeta Qaflehi Skeraj: Faleminderit, Nedžmidin! Atëherë, kemi edhe disa komisione tjera dhe aty do të përfshihen të gjithë. E hedhim në votim Komisionin e vlerësimit për lokalitë 'Venezia'. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Me 21 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe pikën e pestë të rendit të ditës. Atëherë po fillojmë të pika e gjashtë: Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-2-0 ZK Dragash. E kemi krye këtë, e hapim diskutimin. Kryetari e ka fjalën.

Bexhet Xheladini: Vetëm ta jap një sqarim. Vetëm është bërë një ndërrim i pikave. Në vend se me u votue për pikën e pestë, është votuar për pikën e gjashtë. Kështu që, tash le të votohet për pikën e pesëtë, të merret vendimi për dhënie në shfrytëzim të këtij lokali. E pastaj, një herë merret çdo herë vendimi për dhënie në shfrytëzim, pastaj formohet komisioni.

Arijeta Qaflehi Skeraj: Faleminderit, kryetar! A do dikush me e marrë fjalën për pikën e pestë? Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? 22 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë pikën e pestë të rendit të ditës. Atëherë fillojmë te pika e shtatë e rendit të ditës: Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-1-0 ZK Dragash (Zyra e Avokatisë, ish-Pro Credit Bank). A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Me 22 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë këtë pikë. Kalojmë te pika e tetë, propozim për formimin e Komisionit për këtë pikë.

Naser Myrtezani: Ne propozojmë Mehmet Spahiun.

Munir Jonuzi: Falenderoj kryesuese, në emër të Koalicionit Vakati, propozoj veten.

Arijeta Qaflehi Skeraj: Atëherë, Komisioni për Zyrën e Avokatisë është: Isljam Redzeplari dhe Brendi Berisha nga ekzekutivi i Komunës, Shefkat Ismaili nga OJQ 'Zaeno za Brod', Mehmet Spahiun nga LDK dhe Munir Jonuzi nga VAKAT. Kush është pro këtij Komisioni?

Artan Loshaj: Përhëndetje për të gjithë! Znj. Kryesuese, po due me ta bo një pyetje. Këta dy anëtarët e Kuvendit, pse në këtë mënyrë (LDK-VAKAT), kush i propozon? Kush t'i ka dhënë këto koordinata, se dje kryetari na është përzijë në këtë lojë, se kryetari dje në Komitet – e di shumë mirë – na ka propozue ekzekutivin, po na ka nda edhe partitë politike. Kjo domethënë është tejkalim i kompetencave, se këta delegatët i përcaktojmë ne, e jo ju përmes koordinatave të kryetarit. Pse LDK-VAKAT, kur dy herët e para e thirrën PDK-në si parti më e madhe opozitare edhe ma shumë kandidatë që kemi, tash kah erdh kjo? Pse po na servoni VAKAT-LDK? Na është dashtë me bo propozim edhe me qit në votim. Na tash e kemi një kandidat të PDK-së me e qit. Dy të parat shkuan mirë, pse VAKAT-LDK? I marrim të krejtve edhe i qesim në votim. Thashë unë, kjo është tejkalim i kompetencave, se dje kryetari n aka propozue edhe partitë politike qysh do të votojnë. Kryetari është ekzekutiv, i bjer OJQ-në edhe i bjer

ekzekutivin, ndërsa ne delegatët e Kuvendit, të zgjedhurit e popullit, vetë i zgjedhim delegatët, e jo me na servue neve VAKAT-LDK edhe na me votue. Se kjo është krejt tendencë politike, dihet shumë mirë. Këtë lokalitë edhe 'Montanën' nuk po na lë kryetari me qenë kandidatë të PDK-së. Me këto tjerat bën, a di, se me këto tjerat ma lehtë e kemi. Po të them edhe një herë – s'e di sa jam i kuartë – ne vetë delegatët duhet të bëjmë propozime. Na e kemi një propozim, pasi jam këtu, unë e propozoj Nexhat Selajn të jetë në Komisionin për pranimin e dokumenteve.

Nedžmidin Sejdlar: Zonja Kryesuese, nuk e di si keni arritur te Vakati tani. Ju lutemi kushtoni vëmendje, është krejtësisht e vrazhdë kur flas në foltore nëse nuk më dëgjoni. Po ju drejtohem, sepse ju i formoni këto komisione. Jo kryetarit të komunes, sepse ai është në krye të pushtetit ekzekutiv. Detyra e tij është të merret me drejtorët dhe zbatimin e vendimeve. Tani këtu po formojmë komisione dhe ju nuk po më dëgjoni fare. Kjo është krejtësisht e vrazhdë. Nuk e di si keni ardhur këtu deri te Vakati, që të bëjnë propozim për anëtar të komisionit kur komuniteti goran është më i përfaqësuar këtu se Vakati. Pse po diskriminoni komunitetin goran? Ju kolegë nga JGP pse po heshtni. A duhet të vij të të mbroj? A e keni zënë gjuhën, çfarë ka. A duhet të mbroj interesat e njerëzve këtu? Gjendja e kuvendit është e tillë që komuniteti tjetër është komuniteti goran dhe nuk mund të diskriminoni ashtu, nuk mundet në kuptimin që të shkojmë me Vakati, të shkojmë në atë tsipiripi atje, të shkojmë tek ajo Sensa fatkeq. Ne e dimë që këta janë të gjithë njerëzit tuaj, por të paktën tregoni se gjoja po zbatoni një lloj demokracie. Dëshiroj shumë të më përgjigjeni se si keni arritur te Vakati. Pse po diskriminoni komunitetin më të madh në këtë komunë? Pas komunitetit goran, janë përfaqësues të Vakait.

Uran Halimi: Është praktikë edhe rregullore që propozimet së pari bëhen nga partia më e madhe në Kuvend, edhe vazhdon, varet prej përbërjes dhe numrit të delegatëve. Në këtë rast, propozimi i parë i takon PDK-së, si grup më i madh parlamentar, e dyta që propozon është LDK-ja, e dyta me numër të delegatëve, ndërsa VV-ja është në radhë pas LDK-së si grup më i madh parlamentar. Kështu që, unë propozoj që këta komisionerë të propozohen, të ndahen proporcionalisht. Për shembull, ndahen me marrëveshje të grupeve parlamentare përbrenda, e jo propozime nga ekzekutivi. Faleminderit, kryesuese!

Naser Myrtezani: Meqenëse u paraqitën kërkesa tjera nga partitë opozitare, ne si grupim politik e tërheqim emrin e Mehmet Spahiut. Faleminderit!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Naser! Atëherë, pasi u hoq përfaqësuesi i LDK-së, futet propozimi i PDK-së, Nexhat Selaj. Edhe një herë po i lexoj emrat: Isljam Redzeplari dhe Brendi Berisha nga ekzekutivi, Shefkat Ismaili nga 'Zaeno za Brod', Nexhat Selaj nga PDK dhe Munir Jonuzi nga VAKAT. E hedhim në votim. Kush është për këtë Komision? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet ky Komision. Fillojmë me pikën e nëntë: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajshme të Komunës O-70604014-10-2-2-0 ZK

Dragash (lokali përballë Hotelit "MEKA"). A do dikush të marrë fjalën këtu? Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pikës? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet ky vendim. Tash në pikën e dhjetë e formojmë Komisionin për këtë vendim. Atëherë, mua po më mbet borxh Uran Halimi, që pak më herët tha, unë e di që çdo parti më e madhe ka të drejtën më herët, atëherë ju jeni partia e tretë, unë ju kërkoj ndjesë që në këtë Komision është vendos LVV-ja. Ky ka qenë problemi im që e kam qit LVV-në para kësaj. Absolut diçka të keqe s'ka kryetari i Komunës, por unë, diçka kështu më ka shkue, të keqe s'ka se e di që LVV-ja është partia e tretë këtu në Asamble Komunale. Atëherë, e ftoj përfaqësuesin e VV-së që ta sjellin një anëtar për këtë Komision.

Uran Halimi: Faleminderit, znj.kryesuese! Meqenëse Sejdilari u ankua për diskriminim të komunitetit, ne kemi vendos që t'ua lejojmë partive të komunitetit joshumicë me propozue një anëtar të tyre.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Uran! A do dikush prej partive minoritare të marrë pjesë këtu?

Nedžmidin Sejdilar: Përshëndetje kolegë këshilltarë. Koleg Kurt, kërkoj falje që duhet t'ju pyes drejtpërdrejt. Dëshironi të jeni anëtar i këtij komisioni? Meqë ju nuk doni, atëherë nuk më mbetet gjë tjetër veçse të propozoj veten si anëtar i këtij komisioni.

Naser Myrtezani: Ne e propozojmë Agron Gashin.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Atëherë, ky Komision ka këtë përbërje: Isljam Redzeplari dhe Brendi Berisha nga ekzekutivi, Eldina Rexhepi nga OJQ, Agron Gashi nga AAK dhe Nedžmidin Sejdilar nga PG. E hedhim në votim. Kush është pro këtij Komisioni? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë.

Nedžmidin Sejdilar: Zonja Kryesuese, pasi keni detyrime dhe ne e kuptojmë këtë, por keni edhe zevendes këtu. Duke qenë se Spahiju nuk është aty, këshilltari i radhës më i vjetër është Samidin Xheladini, i cili gjithsesi ka dëshirë të jetë kryesues i Kuvendit. Pse të mos e kënaqni atë. Le të shkojmë në një pushim dhe pastaj Samidin të vazhdojë me kuvendin, do të jetë aq argëtuese sa si e filluam.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Nedžmidin! Atëherë po kalojmë te pika e njëmbëdhjetë: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00771-0 ZK Dragash (Byfeja në Shtëpinë e Kulturës - emrin e dertanishëm "Montana"). Kush do me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë? Atëherë, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë këtë pikë të rendit të ditës. Tash fillojmë me pikën e dymbëdhjetë për formimin e Komisionit. Nga PDK-ja, a doni të propozoni ndonjë anëtar?

Driton Ademi: Nga Grupi Parlamentar i PDK-së propozoj Artan Loshaj.

Uran Halimi: Meqenëse e kemi pas një debat, anëtarët të cilët i kanë braktis partitë e veta, aty në lista figurojnë si anëtar të subjekteve bazë nga të cilat i kanë marrë votat. Unë propozoj që nga LVV-ja ta

kemi znj.Pajtesa Berisha.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Atëherë, pasi zonja në fjalë nuk po e pranon, e ftojme përfaqësuesin e JGP-së ta thotë një emër.

Edin Kurt: Pershendetje te gjithëve. Unë kam qenë asambleist sa i përket pagave, kam pasur disa kundërshtime nga kolegët e mi sepse nuk kam qenë gjithmonë prezent në të gjitha mbledhjet e komisioneve, kështu që do të sugjeroja kolege, e cila iku, ndoshta do ta pranojë, Ventaza Esati nga JGP.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Atëherë, Komisioni i vlerësimit për Byfenë në Shtëpinë e Kulturës: Isljam Redzeplari dhe Brendi Berisha nga ekzekutivi, Nuridin Halili nga OJQ ‘Guri i Zi’, Artan Loshaj nga PDK dhe Ventaza Esati nga JGP. Kush është pro këtij Komisioni? A ka kundër? Abstenim? Me 19 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00905-1 ZK Dragash (Parkingu dhe Tregu i Gjelbër). A do dikush me e marrë fjalën këtu? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 22 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Kalojmë te pika e katërbëdhjetë: formimi i Komisionit për këtë vendim.

Artan Loshaj: Ne si Grup Parlamentar i PDK-së e propozojmë Driton Ademin. Edhe – pak me vonesë, znj.kryesuese – po një pyetje kështu, nëse ka mundësi, masi e ke zyrtarin ligjor këtu. Dje më KPF, znj.Xhemile i ka bërë një pyetje kryetarit: A ka mundësi që një asambleist të jetë në këto komisione. Kryetari na ka thënë që nuk ka mundësi. Atëherë, unë juve dua me ju pyet tash ekzekutivit: Si është e mundur që Isljam Redzeplari dhe Brendi Berisha të jenë në më shumë se dy komisione, a kanë të drejtë ligjore a jo?

Naser Myrtezani: Nga radhët e LDK-së propozojmë Mehmet Spahiun.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Atëherë, Komisioni i vlerësimit për Tregun e Gjelbër: Isljam Redzeplari dhe Brendi Berisha nga ekzekutivi, Sinan Qafleshi nga Klubi i Shahut ‘Sharri’, Driton Ademi nga PDK dhe Mehmet Spahiu nga LDK.

Artan Loshaj: Kryesuese më fal, e di që ke me shkue, po u detyrova patjetër. z.Kryetar, dje në KPF, znj.Xhemile ju ka bërë një pyetje. Në këto komisione – për mos me marrë shumë huti – a bën një asambleist, për shembull i PDK-së, me qenë në të gjitha komisionet? Ju keni thënë nuk ka të drejtë. Qysh ka të drejtë tash nga ekzekutivi Isljam Redzeplari dhe Brendi të jenë mbi dy herë, tri herë, katë herë? A keni të drejtë ligjore ju, a veç për ne vlen kjo? Këtë pyetje e pata unë dhe dua një përgjigje.

Bexhet Xheladini: Unë dje të kam thënë kështu: Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal ka lyp për çdo thirrje të bëhet komision i veçantë. Munden me qenë edhe të njëjtit njerëz, nuk është problem. Por,

për çdo thirrje komision i veçantë. Jo një komision për gjashtë thirrje. Kështu që, ju mundeni në dy-tri komisione me propozue një asambleist. Nuk është problem.

Arijeta Qaflehi Skeraj: Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij Komisioni? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë vendim. Fillojmë te pika e pesëmbëdhjetë: Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00782-2 ZK Dragash (Parkingu te Gjykata - Dragash). A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 19 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet ky vendim. Pika e gjashtëmbëdhjetë është zgjedhja e Komisionit për këtë Parkingu te Gjykata në Dragash. A doni me marrë pjesë prej PDK-së? Okej, faleminderit Shpetim! Nga LDK?

Naser Myrtezani: Nga LDK propozojmë Samidin Xheladinin.

Nedžmidin Sejldilar: A është ndonjë propozim, a çka është në pyetje? Unë propozoj vetveten pra.

Arijeta Qaflehi Skeraj: Atëherë, Komisioni i vlerësimit për Parkingu te Gjykata është: Isljam Redzeplari dhe Brendi Berisha, Abaz Qengaj nga OJQ ‘Kroi i Macës’, Samidin Xheladini nga LDK dhe Nedžmidin Sejldilar nga PG. Kush është pro këtij Komisioni? A ka kundër? Abstenim? Me 19 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, edhe ky vendim miratohet.

Atëherë, pasi kemi mbërritur te pika e fundit, pika eventuale, po fillojmë edhe me këtë pikë edhe po e përfundojmë. Para se me e nis pikën eventuale, unë si kryesuese e Kuvendit dua që çdo anëtar i Kuvendit, ata të cilët kanë me bo pyetje, për personin që do t’i përmendet emri, ai ka të drejtë me dhënë përgjigje. Nuk do ta pranoj përgjigjen e tjetërkujt, pa e dashtë anëtari i Kuvendit. Atëherë, ju të nderuar anëtarë. Kush do me e marrë fjalën te pika eventuale?

Artan Loshaj: znj.Kryesuese, pasi thajë kështu, unë drejtorin e Drejtoratit të Shëndetësisë nuk po e shoh, atëherë po duhet patjetër direkt kryetarit me i bo pyetje. z.Kryetar, në fillim të muajit dhjetor e keni hap një konkurs për pesë infermierë dhe ka qenë deri më 15 dhjetor të mbyllet konkursi. Shkuan afër dy muaj, unë e di që as në intervistë me shkrim, as në intervistë me gojë nuk i keni marrë. Çka është puna me këta, a ka mundësi një përgjigje? E dyta, u bëra i tepërt, po e kam obligative me e bo prapë këtë pyetje drejtorit, prapë s’është ai. Qe 11 muaj, Qeveria ka vendos që koeficienti për punëtorët të ndryshohet - Arijeta e di shumë mire – në të gjithë Republikën e Kosovës janë bërë këto ndryshime, veç në Komunën e Dragashit ende nuk ka. Tash na ka ardhë edhe në lista të pagave, prapë me të vjetrën. Domethënë prej koeficientit 5.1 duhet me kaluar në koeficientin 5.4 ata punëtorë të cilët kanë të kryer shkollimin baçelor edhe punëtorët e Urgjencës. Nuk do të foli veç zi, sot e ke një falënderim nga unë edhe të gjithë punëtorët që e kemi pas një contest gjyqësor, të falënderojmë publikisht z.Kryetar, që ke bo zgjidhje në gjykatë, edhe të jemi falënderues. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Po besoj se është e – Zeni, nëse bën, se ma shumë për ju jam

këtu – po më duket se, a ishte e qëllimshme a jo, në të gjitha ato pikat të cilat janë që të shqyrtohen ne eventuale, kisha kërkuar nga drejtori i Arsimit që ta na japë pak sqarime për zgjedhjen e drejtorave nëpër shkolla fillore, kur kemi dy apo tri raste të zgjedhjes së drejtorave të cilët nuk i plotësojnë as kushtet për konkurrim. Sipas Udhëzimit 151 të vitit 2020, në pikën 1.4, thuhet se të drejtë kanë ata kandidat të cilët kanë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim të arsimit. Dhe ajo çka është pika krejt ma e nxehtë është se në këtë Nen 1.77 jepet një deklaratë nën betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati apo kandidatja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat partiake politike. Këtu – do të më kërkojë pak falje kolega, z.Naseri – por nuk e di unë me çfarë të drejte pranon dhe me çfarë të drejte drejtori i DKA-së e emëron drejtor Naser Myrtezanin, kur këtu po thuhet tri vitet e fundit duhet të është larg politikës, ne personin e kemi brenda, e kemi në votim. A nuk është shkelje ligjore, a nuk është z.Naseri vepër penale, që s’po them e rrejshme, po të gënjesht atë deklaratë e cila vjen nga Ministria e Arsimit. A nuk është jo e drejtë para kolegëve që të prezantohesh si drejtor, ty veç këtu të kemi asambleist, vijsh nga partia LDK. Këtu drejtor, nuk dua që të akuzoj pale çka, por nëse ke ndonjë të drejtë ligjore që e ke emëruar si drejtor, urdhëro, eja na bjer një ligj i cili është më i ri se i vitit 2020. Ne këtu kemi – edhe para mediave – që sipas Udhëzimit 151/2020, kandidati duhet që të është të paktën tri vite larg politikës. Nëse ky ligj thotë kështu, ne personin në fjalë e kemi brenda, në ulëset e para, edhe e kemi kryesues të LDK-së. E dyta, te Komisioni i vlerësimeve, unë me sa e di, Komisioni i vlerësimeve të cilin e kemi zgjedhë të gjithë, e kemi miratue këtë zgjedhje, ka qenë me mandat njëvjeçar. Dhe, mandati i tij ka filluar më 1 shtator të vitit 2022 dhe ka përfundue më 31 gusht të vitit 2023. Ne kemi pas shumë polemikë në vitin 2022, që kemi thënë për një vit kalendarik, jo për një vit shkollor. Me ligj është për një vit shkollor. Kanë fillue më 1 shtator 2022 dhe iu skadon më 31 gusht 2023. Është i njëjti Komision që ka fillue me vlerësimin 2023-2024. A nuk është edhe kjo ndeshje me ligjin? Znj.Kryesuese, për këto sigurisht që do të kem ndonjë argument shtesë, të kisha lut që, të paktën për këtë fushë të më japësh edhe replikë. Faleminderit!

Afrore Vejseli: Përshëndetje edhe një herë! E kam një propozim për DKRS-në. Kjo Drejtori brenda vitit ka një agjendë goxha të ngjeshur dhe kjo është shumë mirë. Do të kthehem pak në kohë. Sipas mendimit tim, do të ishte mirë që kjo agjendë të ishte plotësuar edhe me një manifestim të kushtuar eksodit të popullatës opojare, e cila ka ndodhur gjatë luftës, pra në mars të vitit 1999. Arsyet për të organizuar një manifestim janë të shumta, por unë do t’i përmend disa. Nuk duhet të harrohet historia, vuajtja dhe sakrificat, vrasja e të rinjve në fshatin Blaç e Zym, dhe të dihet më shumë për viktimat e luftës. Shpresoj që Drejtoria ta marrë parasysh, të organizojë një manifestim të tillë. E, nëse edhe nuk e sheh të arsyeshme, së paku Komuna të marrë përgjegjësinë për ndërrimin e flamurëve nëpër sheshet dhe varrezat e tyre. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, znj.kryesuese! Ju përshëndes prapë, për s’e di të satën herë! Dje në KPF

kemi diskutue për disa çështje. Vendosa që t'i diskutojmë edhe sot, meqenëse jemi përpara mediave edhe qytetarëve të cilët po besoj se po na ndjekin, ose do të na ndjekin në ndërkohë. E kam ngrit një çështje – në fakt një pyetje ia kam bo kryetarit – për mëditjet e punëtorëve komunalë, të cilët po dyshoj edhe besoj që kanë marrë mëditje edhe të dielave, e edhe ditëve gjatë pushimit vjetor. Një pyetje z.Naserit ia kisha bo, kështu direkt, me respektin më të madh: s'e di a je këtu si delegat apo si drejtor, qysh me të quajt? Po të përshëndes edhe po ta uroj postin e ri! Me ose pa meritë, do ta shohim në ndërkohë, këtë çështje s'due me e diskutue. Nuk je i vetmi që ka – po besoj – shkelje. Po i ceku edhe parafolësi im, z.Nexhat Selaj. E kam një pyetje për kryetarin: te Salla e Sportit në Bresanë, a është përfundue ajo sallë sipas projektit, a janë bërë pagesat për ato punime, edhe realizimi a është bo sipas paramasave të planifikuara? Domethënë, kjo është pyetje sa i përket kulturës, e dish shumë mirë kryetar. Pyetjen që dje ta kam bo në Komitet ishte: a do të vazhdoni me subvencionimet e OJQ-ve prapë, si vitin e kaluar, domethënë dy OJQ për të njëjtin aktivitet, siç ka ndodhë ma herët. Një debat deshta me e bo me znj.Xhylferie Bahtijari, nëse ke pak kohë me më ngue. Para dy viteve, e kemi pas një trajnim në Pejë. Gjatë rrugës u ndalëm në Gjakovë me pi kafe edhe znj.Bahtijari më akuzoi që unë s'po tërhiqem prej kryesuesit. Unë i thashë atëherë, veç dy vjet kam me ndejt kryesues edhe s'kam me qenë kryesues, mirëpo mas dy vjete as ti s'ke me qenë kryesuese. Po besoj që ta kanë vërtetue këtë, se ia kanë nis me i hëngër njerëzit e vet brenda për brenda subjektit politik, e mos të flasim mo për ne si bashkëpartnerë të koalicionit parazgjedhor. Ajo që po më prokupon maksimalisht është që vazhdimisht po bëhet secila punë me tinzëri edhe me dallavere. Kam thënë edhe me një seancë të mëhershme, e kritikova në njëfarë mënyre kryetarin, për pastrimin e rrugëve. Kemi ec edhe po ecim vazhdimisht nëpër ato rrugët e Opojës. Përveç atyre rrugëve që i mërmban Qeveria, rrugët tjera janë pothuajse të pakalueshme, e gjitha që e bëjnë ata borëpastruesit është që veç e shkelin borën, edhe i propoziva kryetarit që, meqenëse ata s'po e pastrojnë borën, po e shkelin, le t'ua blejë ka një valak në vend të traktorëve edhe po besoj se ish shkelë njëtrajtësisht edhe ish bo ma rrafsh ajo. Qytetarët jan t'u pague personalisht dëmtimin e automjeteve, ka ngrica gjithandej edhe sinqerisht, sidomos rruga Zgatar – Blaç – Bresanë është e pakalueshme, në momentin që zateken aty dy makina, është shumë e vështirë me e ndërrue korsinë, me dalë secili automjet në korsinë e vet. Mandej e kemi rrugën Brrut – Trokan, që u konë katrahurë, jo e pastrume, po u konë e shkatërrume, sa i përket mirëmbajtjes së borës. Një çështje tjetër rreth arsimit, meqenëse e kemi drejtorin e DKA-së këtu. Nëse ju kujtohet, në kohën kur unë kam qenë ulur qaty si kryesues, ish-drejtori i Arsimit pat deklarue se në Komunën tonë ekzistojnë 105 mësues tepër. Qeshtu ka thënë drejtori i mëhershëm që ju e keni zëvendësuar. Në anën tjetër, vazhdimisht po shohim konkurse për marrje të mësuesve. Domethënë, ai 105-shi s'e di sa u bo qetash, i nderum drejtor. A mos është më mirë me i zëvendësue ata mësues, sesa me marrë mësues të ri, me e stërngarkue. Dëmi të cilin ia bëjmë ne Komunës sonë është diku 57 mijë euro në muaj, me pagat e këtyre mësuesave të cilët janë

tepër edhe s'kanë norma. Të kisha lut drejtor, që m'u konë pak më i suksesshëm, mos me hap konkurse tjera, me mushë atë numrin – me stërbushë, se veç i mbushur është ai – edhe me e rrit hala ma shumë. Kaq kisha. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Atëherë, përshëndetje edhe një herë për të gjithë! I nderuar kryetar, pyetja që do ta parashtror është direkt për ty dhe ka të bëjë me ty. Është pyetje të cilën e kam parashtrur edhe në seancat e vitit 2023, mos gabofsha, nja dy herë e kam parashtrur, dhe prej përgjigjeve tua ka qenë që shumë shpejt do ta zgjidhim edhe këtë problem, e që ka të bëjë me pagesën e shpenzimit të ndriçimit të fshatrave, atyre fshatrave të cilat e kanë instaluar me vetëfinancim dhe tash e shumë vite e paguajnë vetë. Ti e ke dhënë premtim në fushatë elektorale, në vitin 2022 – në mos gabofsha, kur ta kam bo pyetjen herën e parë – ke thënë që do të ndajmë një buxhet nga shuma e clia i dedikohet fshatrave, atë shumë do ta paguajmë shpenzimin e ndriçimit publik. Kjo nuk ka ndodhur në 2023-tën, prandaj unë jam sot i detyruar prapë ta parashtror pyetjen, kur e ke ndërmend ta marrësh përsipër këtë shpenzim, pasi që një pjesë e madhe e fshatrave, ky investim i instalimit të ndriçimit publik është kryer nga Komuna, merret përsipër tash prapë edhe shpenzimi, ndërsa për fshatrat të cilat e kanë krye vetë, me vetëfinancim, nuk iu merret për bazë shpenzimi. Ju duhet ta kuptoni që së paku buxheti i Komunës për këto fshatra është kursyer dhe tani është e arsyeshme që ta pranoni dhe ta merrni shpenzimin e këtyre fshatrave. Nuk janë pak, veç në Opojë i di që janë nja 4 a 5 fshatra që vetë e kanë krye instalimin, ndërsa tani paguajnë vetë. Nga fshati Zaplluxhe kam pas një person i cili m'u drejtue vetë personalisht – ndoshta ka qenë në kontakt me ju, se tha që kam qenë në kontakt me kryetarin. Fshati Blaç gjithashtu, Zgatari, fshati Kuk dhe disa fshatra tjerë që janë në pjesën e komunitetit pakicë, janë që e paguajnë vetë. Kur planifikoni që këto shpenzime dhe këto fshatra të hyjnë në ombrellën e Komunës dhe pagesat t'i merrni ju përsipër? Ju faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Në takimin ku ishim të pranishëm së bashku në fshatin Globoçicë në shkollën fillore, ku ishte edhe nënkryetar i kuvendit, kur qytetarët e atij fshati ngritën shqetësimin për rrëshqitjen e dheut. Atëherë drejtori juaj i shëndetësisë tha se nuk është problemi ynë dhe se është përgjegjësi e Qeverisë dhe se ata i mirëmbajnë ato rrugë. Ju si i pari i kësaj komune dhe ne si delegatë bashkë me ju kemi obligim që t'i zgjidhim problemet e qytetarëve. Meqenëse ajo pjesë e rrugës është shumë i rrezikshëm dhe nuk e dini se kur mund të ndodhë rënia e gurëve, jam i shqetësuar se mund të ketë ndonjë rezultat fatal, ndaj jam i interesuar, pasi jeni njohur me situatën, si do të reagoni në lidhje me këto pyetje. . A keni ndonjë strategji se si të zgjidhet përgjithmonë ky problem, në mënyrë që qytetarët e fshatit Restelicë dhe Krushevë, që është rruga më e frekuentuar në Gorë, të qarkullojnë të pashqetësuar dhe të sigurt. Herën e fundit ju pyeta për organizatën joqeveritare se çfarë keni ndërmend të bëni. Tani do t'ju bëj një pyetje konkrete, ju i keni caktuar një projekt për kulturën një organizate joqeveritare që

nuk merret fare me kulturë, pse e keni bërë këtë dhe e pyetët komisionin pse e bëri këtë. Kur ajo OJQ ju solli raportin, a e keni lexuar atë raport? A keni qenë të paktën pak të shqetësuar se ku po shpenzohen paratë e qytetarëve të kësaj komune? A e keni parë që në atë raport, ajo organizatë joqeveritare mbush karburant në të njëjtin automjet dy here brenda tre minutave? Faturat më ke dhënë vetë. Unë nuk flas me fjalët e mia. Kam kërkuar një kontroll dhe qasje të dokumenteve zyrtare dhe kam marrë faturat, kam marrë raporte. Në ato fatura, ju keni shumë për karburant në intervale nga 3 deri në 5 minuta. Si e keni pranuar? Laptopi dhe printeri që janë blerë nga ajo organizatë joqeveritare për tre orë punë, a keni kërkuar që të kthehet në pronë publike të komunës. A e regjistroi drejtori i administratës ato pajisje. Duke qenë se ne delegatët kemi firmosur revers dhe kemi detyrimin që t'ia kthejmë komunës pronën e komunës dhe kemi marrë numër rendor. A e keni regjistruar edhe atë laptop dhe printer dhe ku janë tani, dhe nëse nuk është aty kur do të kthehen në pronën e komunës. A i keni kërkuar asaj organiye joqeveritare që t'i kthejë 600 eurot që i ka justifikuar me një faturë të pavulosur, të panënshkruar, pa datë të nënshkruar në një bllok paragon që ka përdorur vetë organizata joqeveritare sepse numrat serialë janë të njëjtë. Vetëm shifra e fundit e bllokut serial ndryshon. Si e pranuat edhe si raport korrekt. Kur do t'i kërkonte asaj OJQ-je që t'i kthejë 600 euro në llogarinë e komunës, sepse janë para të qytetarëve të kësaj komune dhe nuk janë para për kot. Me të njëjtën OJQ kemi marrë një faturë për pagesën e drekes në shumë prej 600 euro. Mirëpo, në Raport nuk kemi asnjë fotografi të zyrtarëve që kanë qenë në atë drekë dhe nuk kemi një listë të të pranishmëve. Sa herë që dikush organizon seminare dhe dreka për ne, ne nënshkruajmë një listë për të justifikuar se ku janë shpenzuar paratë. Pse duhet t'u japim dreka personave private, ju lus me shumë dashamirësi nga kjo foltore që paratë e qytetarëve të mos shkojnë kot dhe të gjitha paratë e pashpenzuara të atij projekti të kërkojnë që të kthehen në arkën e komunes. . Kjo është hera e fundit që e kërkoj kete neprmjet foltores, hapi im i radhës do të jetë konsultimi me prokurorinë, por më parë do të pres raportin e auditorit. Për të parë se si do ta pranojë atë projekt. Kur të mbarojë do t'i çoj të gjitha gjetjet e mia në prokurori, ndaj kushdo që abuzon me paratë e qytetarëve duhet të mbajë përgjegjësi. Para disa javësh isha në spital, kur hyra në Qendrën Shëndetësore pashë që stafi atje po ngrinte. Pse nuk kanë ngrohje, nuk kanë as ujë të ngrohtë. Unë po ju lus që të mos luani me mantila te bardha, se nëse e prishim atë bransh në komunën tonë, na mbetet vetëm të fikim dritën. Faleminderit që keni durimin të më dëgjoni..

Arijeta Qafleshi Skeraj: A ka dikush tjetër që do me e marrë fjalën? Nëse nuk ka nga anëtarët e Kuvendit, atëherë kryetari e ka fjalën.

Bexhet Xheladini: Atëherë po fillojmë me rend, do të ju përgjigjem të gjithëve, nuk ka nevojë drejtorët me dalë këtu. Unë do të përgjigjem në emër të gjithëve. Konkursi për pesë infermierë është në procedurë dhe shpresojmë që brenda pak ditëve do të përfundojë. Sa i përket koeficioentit, nuk është kompetencë e imja, ju duhet të shkoni te Muja edhe t'i bëni kërkesat e juaja, ta çoni dokumentacionin, t'i çoni

dëshmitë, unë jam ai i cili do ta zbatojë koeficientin dhe ligjin dhe rregulloren. Sa i përket zgjedhjes së drejtorëve, ata ende nuk janë zgjedhë, ende nuk janë emëruar, po të foli me argumente, me fakte. Nuk janë zgjedhë, nuk janë emëruar ende, por janë në procedurë. Sa i përket edhe deklaratës nën betim, thashë edhe një herë, drejtorët ende nuk janë emëruar, nuk janë zgjedhë. Emërohen edhe zgjidhen atëherë kur kryetari i komunës e nënshkruan vendimin. Unë ende asnjë vendim nuk e kam shkruar për asnjë drejtor. Për Komisionin e vlerësimeve, nuk kam mundësi tash me t'u përgjigj, do të përgjigjem në Asambleenë e ardhshme. Sa i përket kërkesës që ka bërë përfaqësuesja e LVV-së, për eksodin, është mirë që këto kërkesa t'a drejtoje me shkrim DKRS-së dhe sigurisht që ajo do t'i ketë parasysh kërkesat e juaja, sepse unë mendoj që janë të arsyeshme. Sa i përket Uranit, që tha mëditjet e punëtorëve, unë nuk kam njohuri që kanë marrë punëtorët mëditje, përveç – ka mundësi kanë marrë inxhinierët e Komunës, të cilët janë mbikëqyrës të punimeve në terren, nëse ato kompani kanë zhvilluar punime edhe të shtunën dhe të dielën. Përndryshe punëtorët, staf civil i Komunës, të shtunën e të dielën nuk ka marrë mëditje. Salla në Bresanë ende nuk ka përfunduar, është në përfundim e sipër. Pagesat që është dashtë me u nda me buxhetin i cili ka qenë i miratuar, janë kryer të gjitha, edhe nga buxheti i Komunës edhe nga Granti i Performancës. Por, aty ka edhe shumë punë për t'u bërë, do të shpallet tash tenderi tjetër. Ka edhe punë brenda që do të bëhen, pajisje të brendshme të sallës. Sa i përket pyetjes a do të subvencionohen OJQ-të, normal që Asambleja Komunale ka miratuar diku afër 120-130 mijë euro subvencione, të cilat do t'i menaxhojë DKRS-ja, dhe normal që ne do të vazhdojmë t'i subvencionojmë OJQ-të, klubet, shoqatat etj., normal duke u bazuar çdo herë në thirrjet publike. Sa i përket pastrimit të rrugëve, mendimi im është që ne jemi duke e bërë në mënyrën më të mirë të mundshme pastrimin e rrugëve, me aq sa mundemi, aq sa dimë dhe me ato kapacitete që i kemi. Më shumë këtë vit nuk kemi mundësi. Sa i përket 105 mësuesve tepër, unë këtë informatë po e dëgjoj për herët të parë prej teje. Pagesa e rrymës: jemi në procedurë që gradualisht, fshat pas fshati, jemi duke i kyçur fshatrat në pagesë të rrymës. Masi ma përmende që kam thënë gjatë fushatës, unë i kam edhe një vit e gjysmë, gati dy vjet, kështu që unë këtë premtim do ta çoj në vend. Vetëm këtë vit i kemi shti katër fshatra në pagesë, gradualisht vitin tjetër do t'i shtimë të gjitha fshatrat, për arsye se nuk ka mundësi të gjithëve me ua bë pagesat për një herë, sepse Qeveria nuk na ka pranuar mjetet të cilat i kemi ndarë, na i ka reduktuar mjetet për pagesën e rrymës edhe s'kemi mundësi këtë vit të gjithë me i paguar, por vitin e ardhshëm të gjithë fshatrat – edhe ata të cilët e kanë instaluar ndriçimin publik vetë – edhe këtë vit që kemi disa projekte për ndriçimin e fshatrave, do t'i futim në sistemin e pagesës nga ana e Komunës. Sa i përket Nedžmidin Sejdlarit, për rrugën, në momentin kur është bllokue ajo rrugë, nga drejtori i Shëndetësisë kam marrë njoftimin, m'i ka çue fotografitë, unë e kam thirrë përfaqësuesin e Ministrisë edhe brenda dy orëve rruga është zhblokuar. Por ju e dini që ajo është rrugë regjionale, nuk është në kompetencë të Komunës, por edhe pse nuk është, këtë janë qytetarë të Komunës të cilët kanë nevojë që ajo rrugë të jetë e sigurt

dhe të mos ketë bllokime dhe pasoja, e ndonjë avari tjetër të mundshme. Unë planifikoj që me Ministrinë e Infrastrukturës të kem një kontakt edhe t'ua paraqes këtë problem atyre, që në mënyrën më të shpejtë të mundshme atë ta zgjidhim. Sa i përket subvencioneve në kulturë, unë u përgjigja: do të vazhdojmë me subvencionimin e të gjitha OJQ-ve, klubeve dhe shoqatave, përmes thirrjeve publike. Dëgjo, buxhetin e miraton Asambleja Komunale, DKRS-ja me vendim të kryetarit e bën shpalljen publike për me konkurrue OJQ-të. Pastaj, kryetari i Komunës e formon komisionin për vlerësimin e ofertave. Komisioni e bjer vendimin se cilat OJQ duhet të subvencionohen, atëherë OJQ-të fituese i marrin ato mjete, caktohet menaxheri i çdo projekti të çdo OJQ-je, edhe në fund çdo OJQ e ka për obligim që të paraqesë raport te menaxheri, dhe këtë raport menaxheri duhet t'ia pranojë. Sa i përket llogaridhënies, OJQ-ja e cila nuk e bjer ëncioneve për të cilën e kishte fjalën z.Nedžmidin Sejdilar, edhe pse nuk shkoi me emër, po për afërsisht po e di, ky ka bërë shumë hulumtime, ka pas qasje në dokumente zyrtare, ka bërë edhe fotografime, që nuk është e lejuar por i ka bërë. Ne nga ana jonë e dimë se çdo gjë është në rregull. Nëse zotëria ka argumente që ka keqpërdorime këtu, pasi ta bëjë raportin auditori, lirisht mundet që këtë OJQ ta paraqet në gjyq, edhe unë do të jem edhe argat i yti. Nëse gjykata gjen shkelje, le ta marrin dënimin e merituar të gjitha ata të cilët janë të përfshirë në këtë zinxhir. Deri më tani, këto janë vetëm supozime dhe insinuata, dhe ende nuk janë të vërtetuara. Vetëm gjykata mundet me i vërtetue. Unë nuk kam kohë, kam mysafirë, më shumë s'muj me nejt në sallë. Faleminderit!

Uran Halimi: Të nderum të pranishëm! Unë ma herët i kam bo pyetje kryetarit, në seancën e fundit, ai e ka lënë me u përgjigj drejtori, më ka dhënë përgjigje dikush që unë s'ia kam kërkue. Sot u bëra pyethe individëve të caktuar, duke e përfshirë z.Myrtezanin, drejtorin e Arsimit, kryetari nuk i qiti ata me m'dhënë përgjigje. Sidoqoftë, është i lezetshëm kryetari kur e luan të padijshmin. Nuk e dika që ish-drejtori i DKA-së ka thënë që 105 mësuesja janë tepër. Ju a e dini? S'e dini a? Po unë e di, se jam konë këtu në ulëse të kryesuesit. Merre fjalën, përmirësoje drejtorin. Edhe po due me iu përgjigj atij drejtorit të mjaltit, jam t'u ja përgatit një mjalt goxha djegës, kur ta haje ka me e provue. Mirë u pafshim!

Nexhat Selaj: Përsëritje edhe një herë! Po më vjen mirë që nga gjithë Kabineti udhëheqës i Komunës, e kemi vetëm z.Qamilin, drejtor i Financave. Po të përgëzoj Qamil, po e përgëzoj edhe nënkryetarin. Nga i gjithë stafi janë vetëm dy. Unë nuk di dokument zyrtar, përpos këtij i cili del nga uebfaqja e Komunës dhe jepen të dhëna zyrtare. Shkruan – unë nuk do të lexoj krejt tekstin, vetëm ato fjalët që konstatojnë zgjedhjet e drejtorëve – “Republika e Kosovës, Komuna e Dragashit, Nr113/54 të datës 23.01.2024. Bazuar në Nenin 5 të Ligjit 03/L-068, Komuna vjen me vendim, njofton se në bazë të vlerësimit të përgjithshëm të kandidatëve dhe intervistave në zhvillim, shpall rezultatet e kandidatëve si vijon...”. Z.Naseri, a mund vetëm këtë të ma dokumentosh se çka do të thotë “shpall rezultatet sin ë vijim: Emri i shkollës, pozita, emri dhe mbiemri i kandidatit fitues”. Tash, ShFMU ‘Ilmi Bahtjari’,

drejtor, emri dhe mbiemri i kandidatit fitues thotë Ziadin Meleqi. ShFMU '28 Nëntori' Brodosanë, pozita drejtor, emri dhe mbiemri i kandidatit fitues Naser Myrtezani. Unë nuk di çfarë dokument tjetër duhet përpos këtij. Është nga faqja zyrtare, është njoftimi, është me datë, është me numër të protokollit. Unë nuk e di, kur nuk ke guxim ta udhëheqësh këtë post, unë nuk e di pse rrish ti kryetar. Drejtorit të DKA-së iu drejtova drejtpërdrejt, kur nuk ke guxim, unë nuk di pse rrish këtu, pse vijsh. Kryetari bëhet sikur në kohën e komunizmit, më vjen keq që shprehem i tillë, si në Korenë e Veriut, gjithçka unë di. Po nuk dijs. Doli Qamili, na gjithçka që bëme replikat te financat, doli zotëria këtu, na dha ato sqarimet, sa ishim të kënaqur ishte diçka tjetër, por ishte i fushës së vet. Unë kërkoj drejtori i Arsimit këtu le të dalë të japë deklaratë. Nëse hiç tjetër, e kemi juristin, paguhet nga Komuna. Z.Juristi, Ademi, del ti sqaroje, jepju qytetarëve, se paguhesh nga ky institucion, jepju qytetarëve, çfarë do të thotë kjo zgjedhje e drejtorëve. Ku, në bazë të ligjit 151 të vitit 2020, thuhet se nuk ka të drejtë konkurrimi si drejtor, nëse është ushtrues i ndonjë aktiviteti politik këto tri vitet e fundit. Ne kolegun e kemi këtu. Po më vjen shumë keq që po detyrohem koleg, se koleg e kam edhe në aspektin profesional, edhe në aspektin e qeverisjes. Tash, çka ma tepër, nuk di kujt i mbetet me dhënë llogari.

Nedžmidin Sejdilar: Unë do t'i kërkoja mediave të tregojnë se si duken karriget e koalicionit qeverisës, kjo tregon se sa të interesuar janë për këtë popullë. Nëse do të kishit mirësinë të tregoni se sa këshilltarë nga qeveria janë të pranishëm këtu. Ne nga opozita duhet të krijojmë kuorum për ta. Ata janë kaq të interesuar për qytetarët e kësaj komune. Tjetër gjë, në vend që kryetari i komunës të thotë pak më herët, ne do të hetojmë, do të shohim, ai më akuzon mua për gënjeshtër apo insinuata. Do të tregoheshit aq mirë sa të më thoni, a do ta pranoni këtë lloj faturë? Këtu, le të shehë kamera. Nuk mund ta kuptoj kryetarin e komunës, në vend që të thotë do ta shqyrtojmë edhe komisionin pse e miratoi atë projekt, do ta shqyrtojmë edhe raportin, do të kërkojmë kthimin e parave, do të bëjmë listën e zezë OJQ-të që manipuluan paratë, ai thotë z.Sejdilar bën insinuata dhe gënjeshtër. Plus thotë se kam bërë foto, thjesht kam kërkuar akses në dokumente publike, një e drejtë që më takon me ligj, jo vetëm si delegat por edhe si qytetar i kësaj komune. Më intereson se ku shpenzohet çdo euro. Dhe këtu për më pak se një orë u keqpërdorën më shumë se 2500 euro. Është turp, dikush duhet të mbajë përgjegjësi këtu. Ato para duhet të kthehen në buxhetin e komunës. Faleminderit.

Driton Ademi: E kisha një pyetje për kryetarin, por pasi nuk është kryetari, ose drejtori i Financave ose kolega le të paraqitet. Ia kam bërë një pyetje kryetarit seancën e kaluar, se kush është drejtor në shkollën e Bresanës, kryetari nuk m'u ka përgjigj. Një vendim të cilin e kam siguruar, thuhet se është Durim Myrtezani nga fshati Zaplluxhe. A bën me e dit, kush është Durim Myrtezani nga fshati Zaplluxhe, U.D. mbi U.D. me sa e kam kuptue unë. Domethënë, je konë U.D. ti, Naser, po të kanë pru U.D. tjetër, se u folë nëpër shkollë që është dikush t'u hy e t'u dalë, por nuk është t'u ditë kush është drejtori me atë shkollë. Është mirë me dalë për opinionin publik, për qytetarët, për kolegët e juaj që i

keni në shkolla, se kush është drejtor në shkollën e Bresanës, se as kolegët e juaj nuk janë t'u e ditë kush është drejtor. Lirisht mundesh me u kesh ti me atë, po unë e di që mundesh me u kesh se ata e kuptojnë. Edhe, plus një deklaratë që e keni dhënë në Insajder, është e pahijshme, a je t'u kuptue, që po e gënjeni publikisht opinionin publik. Kisha pas qef këtë përgjigje me e marrë, ose prej teje ose prej ekzekutivit. Edhe një pyetje – kryetari nuk është, po deshta me e ditë, e kam bo një kërkesë para se me u miratue buxheti, në dëgjim buxhetor nëpër fshatra, një kërkesë të fshatit Bresanë, besoj që nënkryetari munden me e ditë. Te pjesa e Varrezave që vjen një ujë edhe kalon nëpër varreza, nëpër rrugë kryesore, aty këmbësorët kur bjer shi kanë shumë problem për me ec. Deshta me e paraqit një pyetje, a ka mundësi me e shti në pjesën prej të hyrave të buxhetit, prej kthimit të buxhetit që bëhet tash në mars? Faleminderit!

Samidin Xheladini: Të nderuar kolegë! Ndoshta nuk është e hijshme unë me dhënë, se s'më takon me dhënë përgjigje, por për atë pjesën teme si koleg prezent që jeni, po due me jua tregue një të vërtetë. Ndoshta s'është e hidhur, por për ju të PDK-së qysh po paraqituni këtu, është e hidhur. Naser Myrtezanin të PDK-së po e zgjedhin drejtor, kolegët e PDK-së dhe kolegët e shkollës. S'jam unë kryetar i Komunës, nuk po jap llogari, unë po ju njoftoj edhe po e di saktë që kjo është e vërtetë. Edhe e dëshmoj me argumente, a është e vërtetë Naser? Kam dëshmi edhe fakte që ata e kanë shti, ky s'ka pas qef me hi. S'ka pas qef edhe s'ka qef sot me hi. Po kërkon kolektivi i shkollës edhe njerëzit, edhe prindërit edhe krejt po kërkojnë. Driton, edhe ti ke kërkuë, po, në mbledhjen e prindërve atje ke qenë prezent kur ka ndodhë. Po sigurisht, jo me kërkuë, po kundër nuk je. As ju nuk jeni kundër. Ju lutem, mos e bëni debat këtë punë, qeky është realiteti. Po e kërkojnë të PDK-së, po e dojnë ma shumë se na të LDK-së. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! E di që ka humb edhe motivi për me vazhdue me seancën, por edhe nuk kemi nga ekzekutivi njerëz kompetentë. Por, deshta ta bëj një pyetje: e nderuar kryesuese, në fillim të pikës së fundit, eventuales, e lexove një rregullore. Asaj rregulloreje nuk iu përmbajt ekzekutivi. A vlen ajo për ekzekutivin, a vlen veç për ne asamblesitët? Edhe, ta Samidin, ata të PDK-së s'po ia dojnë të mirën po më doket profit Naser. Le të ka kujdes, se po shkon prapa grilave! Faleminderit!

Driton Ademi: Edhe një pyetje e kam për fund: Komisioni i pagave, a muj me e ditë ku është me ngjarje, ku ka mbet? Ka pas me u pru në qershor, jo në tetor, jo në nëntor, u bënë qe 6-7 muaj e ky Komision nuk ka ardhë në Kuvend.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit! E mbyllim këtë seancë! Mirë u pafshim në seancën e radhës!